



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4664 Prot.

Prëshen më, 16 . 11 . 2020

Mbledhja nr. 14 / 2020.

N J O F T I M

Për Thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53 pika 2, pika 4 ; neni 56 pika 2, shkronja "a", neni 55 të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak Mirditë e miratuar me Vendim nr. 35, datë 10. 04. 2020, njofton thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ditën e **Premte datë 20. 11. 2020, ora 10⁰⁰** në **Sallën e Pallatit Kulturës në katin e II - të:**

1. **P/ Vendim** i Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën deri në 6 %, për periudhën **01-31 Tetor 2020**", bashkia Mirditë.
2. **P/ Vendim** i Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin e zbatimit të projektit; "Rehabilitimi i rrjetit ujitës Malaj-Tarazh dhe mandatimin e kryetarit të bashkisë Mirditë Z. Ndrec DEDAJ, për të nënshkruar kontratën e grantit me Programin e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (PZHRSH)".
3. **P/ Vendim** i Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin për heqje detyrimesh kontraktuale për vitin 2021, për pasurinë nr.2/68, ZK. 3224, qyteti Prëshen", bashkia Mirditë.
4. **P/ Vendim** i Kryesisë Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Paketës Fiskale Vendore 2021", bashkia Mirditë.
5. **P/ Vendim** i Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin e rikonstruksionit dhe zgjerimit të rrugës këmbësore, në rrugë automobilistike, që fillon nga aksi i rrugës Bulshizës nr.03200002 deri në banesën e fundit të fshatit Bulshizë, njësia administrative Rubik, 4603", bashkia Mirditë.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

- **KOMISIONI I EKONOMISË, FINANCAVE DHE BUXHETIT.**

Aleksandër LUSHA (kryetar), Endrik SIMONI (zv.kryetar), Mark PRENGA; Valmir PRENGA; Pjetër PJETRI; Nikoll PRENDI dhe Ndue CEKU (anëtarë); Komisioni do të shqyrtojë Projekt-vendimet në **pikat 1, 3 dhe 4 (Paketa Fiskale)** të rendit të ditës, dhe do të mbledhet **ditën e mërkurë datë 18.11.2020, ora 11: 00.**

- ✦ Pika nr. 1, dhe 4 e rendit të ditës; materialet e këtyre projekt-vendimeve, do të dërgohen në versionin elektronik email), me datë 13.11.2020, të gjithë këshilltarëve), për arsye volumi të madh faqesh, ndërsa projektet të tjera dërgohen në zarf me postë.

Duke ju falenderuar për kontributin dhe bashkëpunimin!

K R Y E T A R

Pjeter PJETRI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al